

KARTELË INFORMATIVE

AL112049

1. Emri i shërbimit	Librezë kontributesh për personat e siguruar vullnetarisht, në skemën e sigurimit vullnetar			
2. Cili është qëllimi i shërbimit?	Libreza e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe sigurimit të kujdesit shëndetësor është dokumenti bazë me të cilin pajiset çdo kontributpagues, që evidenton kontributet e paguara dhe shërben si dokument bazë individual për realizimin e së drejtës për përfitime e shërbime. Ky shërbim i vlen qytetarëve si dokument ku vërtetohet se ai ka derdhur kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Libreza e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore shërben dhe paraqitet si dokument për tu pajisur me Kartën Shëndetësore. Në librezën e kontributeve pasqyrohen periudhat mujore dhe masa e kontributit shoqëror dhe shëndetësor për të cilën personi është siguruar			
3. Çfarë ofron ky shërbim?	Libreza e kontributeve të sigurimeve shoqërore i shërben të siguruarit për të vërtetuar shumën e kontributeve të paguar sipas periudhave, në rastet kur kërkon përfitime për pension, sipas ligjit nr 7703, dt 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.			
4. A jam përfitues?	Çdo qytetar që është i siguruar vullnetarisht në skemën e sigurimit vullnetar			
5. Çfarë dokumentesh duhen për aplikim?	Nr	Lloji	Nga lëshohet?	Vlefshmëria
	I vetëpunësuar i në qytet			
	1	Numri Unik i Identifikimit të Subjektit (NUIS)	Qendra Kombëtare e Biznesit	
	2	Fotokopje e nënshkruar e letërnjoftimit elektronik	Sigurohet nga vetë institucioni	
	3	Mandatarkëtimi i pagesave të kontributeve	Banka	
	I vetëpunësuar i në fshat			
	1	Çertifikatë pronësie	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	
	2	Mandatarkëtimi i pagesave të kontributeve	Banka	
	Personat e siguruar vullnetarisht			
	1	Fotokopje e nënshkruar e dokumentit të identifikimit	Sigurohet nga vetë institucioni	
2	Mandatarkëtimi i pagesave të kontributeve	Banka		
6. Ku mund të aplikoj?	Zyrat pritëse	Qyteti	Adresa	Orari
	Sportelet ADISA; Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Agjencia Lokale e Sigurimeve Shoqërore (ALSSH)	Sportelet ADISA Kavajë, Krujë, Fier dhe Gjirokastrë; Sportelet ALSSH Tiranë	ADISA:www.adisa.gov.al Agjencitë 1. Rr: "Myslym Shyri", përballë ADIDAS 2. Njësia bashkiake në Kombinat 3. Kinostudio përballë Shkollës së Bashkuar DRSSH Tiranë 1. Rr: "Sandër Prosi", përballë Inxhinierisë së Ndërtimit ISSH 1. Rruga e Durrësit, Nr. 83, Tiranë	ADISA: E Hënë- E premte, ora 08:00-15:00 ALSSH E Hënë - E Premte ora 08:30 - 16:00; E Shtunë ora 08:30 - 12:00
	Niveli 1 Ofrohet informacion mbi shërbimin	Niveli 2 Ofrohet informacion dhe mundësi shkarkimi i formularit të aplikimit	Niveli 3 Ofrohet informacion dhe mundësi për dorëzimin e aplikimit online	Niveli 4 Shërbimi ofrohet tërësisht online
	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>
8. Sa është tarifa për marrjen e shërbimit?	Tarifa bazë Në sportel: 100 lekë	Tarifa shtesë	Mënyra e pagesës	
9. Sa kohë nevojitet për të marrë shërbimin?	3 ditë			
10. Çfarë përfitoj?	Libreza e kontributeve të sigurimeve shoqërore			
11. Ç'afat vlefshmërie ka?	I vlefshëm deri në plotësimin e kushteve për të përfituar pension nga kushtet e ligjit të mësipërm			
12. Ku e marr?	Në sportele <input checked="" type="checkbox"/>	Me postë <input type="checkbox"/>	E- albania <input type="checkbox"/>	Me e-mail <input type="checkbox"/>

13. Cili është institucioni përgjegjës?	<i>Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH)</i>			
14. Ku mund të gjej informacion për këtë shërbim?	Kontakto në:		Orari	
	<i>E- albania:e-albania.al</i> <i>ADISA web: www.adisa.gov.al</i> <i>ADISA email: Informacion@adisa.gov.al</i> <i>ISSH web: www.isssh.gov.al</i> <i>Call Center: 11800</i>		<i>Call Center: E Hënë-E Premte, ora 07:00-21:00</i> <i>E shtunë, ora 07:00-14:00</i>	
15. Nëse kam ankesë, si të veproj?	Në sportele	<input checked="" type="checkbox"/>	Me postë	<input type="checkbox"/>
	Në platformën "Shqipëria që duam"	<input checked="" type="checkbox"/>	Me internet	<input type="checkbox"/>
	Link: www.shqiperiaqeduam.al		Me e-mail	<input type="checkbox"/>
16. Cila është baza ligjore e këtij shërbimi?	<ul style="list-style-type: none"> • VKM nr. 77, datë 28.01.2015 "Per kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimit të kujdesit shëndetësor" ; • Rregullore nr.2, datë 2.12.2008 "Për kontributet e sigurimeve shoqërore; • Rregullore e ISSH nr.4, datë 25.05.2009 "Për Sigurimin vullnetar në ISSH. 			